# LAJTHIZA INVEST SHA

***Pasqyrat financiare vjetore***
***për periudhën nga***
***1 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023***

**Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

***Përmbajtja***


Pasqyra e pozicionit financiar

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Pasqyra e flukseve të parasë

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

1. Informacion i përgjithshëm
2. Bazat e përgatitjes
3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet
4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël
5. Raportimi per herë të parë sipas SNRF-ve
6. Standardet e reja dhe amendimet
7. Aktive afatgjata materiale
8. Aktive Afatgjata jo materiale
9. Investime në pjesëmarrje
10. Inventari
11. Të drejta të arkëtueshme tregëtare
12. Shpenzime të shtyra
13. Të arkëtueshme të tjera
14. Mjete monetare dhe të ngjashme
15. Kapitali dhe rezervat
16. Hua dhe detyrime te tjera afatgjata
17. Te tjera te pagueshme
18. Huatë nga institucionet financiare
19. Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme
20. Detyrime tatimore
21. Llogari të pagueshme e të tjera
22. Te ardhurat nga aktiviteti kryesor
23. Të ardhura të tjera

23\. Kosto e Mallrave dhe produkteve të shitura

25\. Shpenzime për personelin

26\. Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto

27\. Shpenzime të tjera

28\. Tatim fitim

29\. Menaxhimi i rrezikut

**Pasqyra e pozicionit financiar**

| | | IFRS | IFRS | IFRS |
|---|---|---|---|---|
| | | **31 Dhjetor 2023** | **31 Dhjetor 2022** | **31 Dhjetor 2021** |
| **AKTIVE** | Shënime | | | |
| **Aktive afatgjata** | | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 7 | 3,861,587,598 | 3,554,038,980 | 3,057,920,664 |
| Aktivet jo-materiale të tjera | 8 | 190,292,332 | 200,307,718 | 210,850,230 |
| Investime ne pjesemarrje | 9 | 34,000,000 | 23,800,000 | 2,800,000 |
| **Total - Aktive aftagjata** | | **4,085,879,930** | **3,778,146,698** | **3,271,570,894** |
| | | | | |
| **Aktive aftashkurtra** | | | | |
| Inventari | 10 | 1,354,012,962 | 1,485,400,717 | 1,033,869,113 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 11 | 692,424,868 | 442,649,689 | 266,368,353 |
| Shpenzime te shtyra | 12 | 303,326,351 | 101,327,373 | 145,722,605 |
| Nga njesite ekonomike brenda grupit * | | 72,768,687 | 31,337,303 | 19,074,503 |
| Te arketueshme te tjera | 13 | - | 46,401,885 | 30,392,294 |
| Mjete monetare dhe të ngjashme | 14 | 87,450,465 | 101,466,551 | 65,210,691 |
| **Total - Aktive afatshkurtra** | | **2,509,983,333** | **2,208,583,517** | **1,560,637,559** |
| **TOTAL AKTIVE** | | **6,595,863,263** | **5,986,730,215** | **4,832,208,453** |
| | | | | |
| **KAPITALI DHE DETYRIMET** | | | | |
| Kapitali aksionar | 15 | 854,000,000 | 724,000,000 | 407,000,000 |
| Rezerva te tjera | | 448,796,192 | 470,260,788 | 627,077,520 |
| Fitim i pashpërndarë | | - | - | - |
| Fitim i vitit | | 654,646,180 | 98,567,387 | 99,978,204 |
| **Total – Kapitali** | | **1,957,442,372** | **1,292,828,175** | **1,134,055,724** |
| | | | | - |
| **Detyrime afatgjata** | | | | - |
| Huatë nga institucionet financiare | 16 | 1,020,610,172 | 969,677,166 | 823,948,593 |
| Te tjera te pagueshme | 17 | 3,025,078,667 | 2,906,234,728 | 2,143,405,315 |
| **Total - Detyrime afatgjata** | | **4,045,688,839** | **3,875,911,894** | **2,967,353,908** |
| | | | | - |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | | - |
| Huatë nga institucionet financiare | 18 | 233,435,891 | 425,189,563 | 469,947,410 |
| Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme | 19 | 185,491,342 | 341,578,643 | 260,851,411 |
| Detyrime tatimore | 20 | 164,525,241 | 34,620,504 | - |
| Te tjera te pagueshme | 21 | 9,279,578 | 16,601,436 | - |
| **Total - Detyrime afatshkurtra** | | **592,732,052** | **817,990,146** | **730,798,821** |
| **Total - Detyrime** | | | | - |
| **TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET** | | **6,595,863,263** | **5,986,730,215** | **4,832,208,453** |
| | | | - | - |
| | | (0) | | |

**Thanas SIVERI**
**Drejtor i përgjithshëm**

**Valbona ALUSHI**
**Drejtor i financës**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

| | Shënime | IFRS 31 Dhjetor 2023 | IFRS 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|---|
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 22 | 3,204,325,074 | 2,499,123,295 |
| Te ardhura nga investimet | 23 | 263,685,445 | 230,264,658 |
| Te ardhura te tjera | 23 | 192,044,646 | 96,550,006 |
| **Totat i të ardhurave nga aktiviteti** | | **3,660,055,165** | **2,825,937,960** |
| Ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces | 24 | (172,248,057) | 143,845,747 |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | | (900,261,964) | (921,064,374) |
| Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi | 7 | (488,633,862) | (462,597,048) |
| Shpenzime personeli | 25 | (254,167,043) | (220,500,268) |
| Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto | 26 | 43,856,398 | 130,786,177 |
| Shpenzime te tjera | 27 | (1,117,947,135) | (1,380,070,888) |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) nga pjesmarrjet (filjal/dege) | | | |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) nga bashkimet ekonomike (joint-venture) | | | |
| Fitime te njohura nga shitja e pjesmarrjeve | | | |
| Te tjera (pershkruaj) | | | |
| **Total i shpenzimeve** | | **(2,889,401,662)** | **(2,709,600,654)** |
| **Fitimi para tatimit** | | **770,653,503** | **116,337,306** |
| | | - | - |
| Tatimi mbi fitimin | 28 | (116,007,323) | (17,769,919) |
| **Fitimi neto per periudhën** | | **654,646,180** | **98,567,387** |
| | | - | - |
| ***Të tjera të ardhura gjithpërfshirëse*** | | - | - |
| | | - | - |
| **Totali i fitimeve gjithpërfshirëse** | | **654,646,180** | **98,567,387** |

**Thanas SIVERI**
**Drejtor i përgjithshëm**

**Valbona ALUSHI**
**Drejtor i financës**

LAJTHIZA INVEST SH.A - Production - Exp - Imp - Lajthiza Premium Water NATYRAL ALBANIA

Lajthiza Invest Sh.A. - J98009202P

| Pasqyra e flukseve të parasë | Indirect<br>31 Dhjetor 2023 | 31 Dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **Aktivitetet e shfrytëzimit** | | |
| **Fitimi para tatimit** | **654,646,180** | **98,567,387** |
| ***Rregullime për të rakorduar humbjen neto me fluksin neto të parasë*** | | |
| Amortizime dhe zhvlerësime | 488,633,862 | 462,597,048 |
| Humbje nga kursi i këmbimit,neto | | |
| Zhvlerësime për borxhin e keq | | |
| **Rregullime per kapitalin qarkullues:** | | |
| Pakesim në inventare | 131,387,755 | (451,531,604) |
| Zvogelim/(Rritje) në llogari të arkëtueshme | (249,775,179) | (160,158,495) |
| ZvogelimRritje në parapagime dhe te arkëtueshme të tjera | (197,028,477) | |
| (Rritje)/Zvogelim në të ardhura të shtyra | | |
| Rritje/Zvogelim në llogari të pagueshme | (156,087,301) | 97,328,668 |
| Te tjera | 122,582,879 | 34,620,504 |
| Mjetet monetare të përfituara nga aktivitetet e shfrytezimit | **794,359,719** | **81,423,508** |
| Tatim i paguar | | |
| **Mjetet monetare neto të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit** | **794,359,719** | **81,423,508** |
| **Aktivitetet e investimit** | | |
| Blerje e shoqerise se kontrolluar minus parate e arketuara | (10,200,000) | (21,000,000) |
| Blerje (shitje) aktivesh afatgjata materiale | (826,286,764) | (1,196,202,742) |
| Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | 29,980,691 | 32,267,008 |
| Dividendet e arketuar | | |
| Pagesa per blerjen e investimeve te tjera | | 213,739,820 |
| Interesi i arketuar | | |
| Te tjera (Rregullim per fitimin nga shitja e AQT) | (11,325,618) | 2,023,062 |
| **Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit** | **(817,831,691)** | **(969,172,852)** |
| **Aktivitetet financuese** | | |
| Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar | 70,000,000 | 317,000,000 |
| Huamarrje | -21,976,727 | 863,800,139 |
| Pagese dividenti | (38,567,387) | (33,200,622) |
| Te tjera (pershkruaj) | | (223,594,314) |
| **Mjetet monetare neto përdorur në aktivitetet financuese** | **9,455,886** | **924,005,203** |
| **Rritje e mjeteve monetare** | **(14,016,085)** | **36,255,859** |
| **Efekti i kursit të këmbimit mbi mjetet monetare** | | |
| **Mjetet monetare në fillim të periudhës** | 101,466,550 | 65,210,691 |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës** | **87,450,465** | **101,466,550** |

**Thanas SIVERI**
**Drejtor i përgjithshëm**

LAJTHIZA INVEST SH.A. Exp - Imp - Production Lajthiza Premium Water NATYRAL ALBANIA

**Valbona ALUSHI**
**Drejtor i financës**

Lajthiza Invest Sh.A. - J98009202P

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

| | Kapital i nenshkruar | Primi i lidhur me kapitalin | Rezerve rivleresimi dhe te tjera | Fitim i pashperndare | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 1 janar 2022** | **407,000,000** | **9,690,915** | **617,386,605** | **99,978,204** | **1,134,055,725** |
| | | | | | - |
| Fitim i vitit | | | | 98,567,387 | 98,567,387 |
| Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera | | | | | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse** | | | | **98,567,387** | **98,567,387** |
| | | | | | - |
| Riklasifikimi i rezerves se rivleresimit sipas SNRF (Shenimi 5.A) | | | (22,594,313) | | (22,594,313) |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse sipas efektit të SNRF** | | | **(22,594,313)** | **98,567,387** | 75,973,074 |
| Riklasifikim nga rezerva rivleresimi | 317,000,000 | | (134,222,418) | (66,777,582) | 115,999,999 |
| Dividente te deklaruar | | | | (33,200,623) | (33,200,623) |
| Transferim I fitimeve ne Rezerva | | | - | | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2022 sipas SNRF** | **724,000,000** | **9,690,915** | **460,569,874** | **0 98,567,387** | **0 1,292,828,175** |
| | | | | | - |
| Fitim i vitit | | | | 654,646,180 | 654,646,180 |
| Riklasifikimi i rezerves se rivleresimit sipas SNRF (Shenimi 5.A) | **130,000,000** | | | **(60,000,000)** | 70,000,000 |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse** | **130,000,000** | | | **594,646,180** | **724,646,180** |
| Riklasifikim nga rezerva rivleresimi | | | (21,464,597) | | (21,464,597) |
| Dividente te deklaruar | | | | (38,567,387) | (38,567,387) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2023** | **854,000,000** | **9,690,915** | **439,105,277** | **654,646,180** | **1,957,442,372** |
| | | | 0 | (0.40) | 0 |
| | | | - | | 0 |

**Thanas SIVERI**
**Drejtor i përgjithshëm**

**Valbona ALUSHI**
**Drejtor i financës**

**(b) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Më poshtë paraqiten marrëdhëniet kontraktuale, maturiteti i mbetur i aktiveve financiare dhe detyrimet duke përfshirë pagesat e interesit deri më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022

| *31-Dec-23* | Vlera e mbartur | < 3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-10 vjet |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive financiare*** | | | | | |
| Të drejta të arkëtueshme, neto | **692,424,868** | 53,111,453 | 252,140,947 | 25,985,326 | 361,187,141 |
| Nga njesite ekonomike brenda grupit * | **72,768,687** | | | 72,768,687 | |
| Te arketueshme te tjera | **0** | | | | |
| Shpenzime te shtyra | **303,326,351** | | | | 303,326,351 |
| **Total** | **1,068,519,906** | **53,111,453** | **252,140,947** | **98,754,013** | **664,513,492** |
| ***Detyrime financiare*** | | | | | |
| Huatë nga institucionet financiare | **1,254,046,063** | | | 233,435,891 | 1,020,610,172 |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | **164,525,241** | 164,525,241 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | **185,491,342** | | | 185,491,342 | |
| Te tjera te pagueshme | **9,279,578** | | | 9,279,578 | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | **3,025,078,667** | | | | 3,025,078,667 |
| **Total** | **4,638,420,891** | **164,525,241** | **0** | **428,206,811** | **4,045,688,839** |
| | *(3,569,900,985)* | *(111,413,788)* | *252,140,947* | *(329,452,798)* | *(3,381,175,347)* |

| *31-Dec-22* | Vlera e mbartur | < 3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-10 vjet |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive financiare*** | | | | | |
| Të drejta të arkëtueshme, neto | **442,649,690** | 165,328,445 | 61,316,423 | 216,004,822 | |
| Nga njesite ekonomike brenda grupit * | **31,337,303** | | | | 31,337,303 |
| Te arketueshme te tjera | **46,401,885** | | | 46,401,885 | |
| Shpenzime te shtyra | **101,327,373** | | | 101,327,373 | |
| **Total** | **621,716,251** | **165,328,445** | **61,316,423** | **363,734,080** | **31,337,303** |
| ***Detyrime financiare*** | | | | | |
| Huatë nga institucionet financiare | **1,394,866,729** | 0 | 0 | 425,189,563 | 969,677,166 |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | **34,620,504** | 34,620,504 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | **341,578,643** | 221,713,794 | 27,781,973 | 92,082,876 | |
| Te tjera te pagueshme | **16,601,436** | 16,601,436 | | | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | **2,906,234,728** | | | | 2,906,234,728 |
| **Total** | **4,693,902,040** | **272,935,734** | **27,781,973** | **517,272,439** | **3,875,911,894** |
| | *(4,072,185,789)* | *(107,607,289)* | *33,534,450* | *(153,538,359)* | *(3,844,574,591)* |

| *01-Jan-22* | Vlera e mbartur | < 3 muaj | 3-6 muaj | 6-12 muaj | 1-10 vjet |
|---|---|---|---|---|---|
| ***Aktive financiare*** | | | | | |
| Të drejta të arkëtueshme, neto | **266,368,353** | 26,322,866 | 27,323,939 | 212,721,548 | - |
| Nga njesite ekonomike brenda grupit * | **19,074,503** | | | | 19,074,503 |
| Te arketueshme te tjera | **30,392,294** | | | | 30,392,294 |
| Shpenzime te shtyra | **145,722,605** | | | 145,722,605 | |
| **Total** | **461,557,755** | **26,322,866** | **27,323,939** | **358,444,153** | **49,466,797** |
| ***Detyrime financiare*** | | | | | |
| Huatë nga institucionet financiare | **1,293,896,003** | | | 469,947,410 | 823,948,593 |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | **17,273,167** | 17,273,167 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | **231,078,244** | 34,185,813 | 55,477,076 | 141,415,355 | |
| Te tjera te pagueshme | **12,500,000** | | 12,500,000 | | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | **2,143,405,315** | | | | 2,143,405,315 |
| **Total** | **3,698,152,729** | **51,458,980** | **67,977,076** | **611,362,765** | **2,967,353,908** |
| | *(3,236,594,974)* | *(25,136,114)* | *(40,653,137)* | *(252,918,612)* | *(2,917,887,111)* |

Lajthiza Invest Sh.A. - J98009202P

(c) **Rreziku i Tregut**

*Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës*

| *31-Dec-23* | Vlera e mbartur | EUR | USD | LEK | Franga |
|---|---|---|---|---|---|
| Investime ne pjesemarrje | 34,000,000 | | | 34,000,000 | |
| Llogari te arketueshme tregtare | 692,424,868 | 109,485,210 | 6,472,030 | 576,467,628 | |
| Shpenzime te shtyra | 303,326,351 | 15,674,751 | | 287,651,600 | |
| Nga njesit ekonomike brenda grupit | 72,768,687 | | | 72,768,687 | |
| Te arketueshme te tjera | 0 | | | | |
| Mjete monetare dhe të ngjashme | 87,450,465 | 26,104,566 | 5,874,156 | 55,452,467 | 19,277 |
| Huatë nga institucionet financiare | (1,254,046,063) | -1,254,046,063 | | | |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | (164,525,241) | -164,525,241 | | | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | (185,491,342) | -139,822,944 | -1393408.26 | (34,017,821) | (10,257,169) |
| Te tjera te pagueshme | (9,279,578) | | | (9,279,578) | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | (3,025,078,667) | | | (3,025,078,667) | |
| **Pozicioni neto** | **(3,448,450,520)** | ***(1,407,129,721)*** | ***10,952,777*** | ***(2,042,035,684)*** | ***(10,237,892)*** |

| *31-Dec-22* | Vlera e mbartur | EUR | USD | LEK | Franga |
|---|---|---|---|---|---|
| Investime ne pjesemarrje | 23,800,000 | | | 23,800,000 | |
| Llogari te arketueshme tregtare | 442,649,689 | 103,596,991 | 6,628,041 | 332,424,657 | |
| Shpenzime te shtyra | 101,327,373 | | | 101,327,373 | |
| Nga njesit ekonomike brenda grupit | 31,337,303 | | 0 | 31,337,303 | |
| Te arketueshme te tjera | 46,401,885 | | | 46,401,885 | |
| Mjete monetare dhe të ngjashme | 101,466,551 | 40,744,863 | 2,295,633 | 58,398,421 | 27,634 |
| Huatë nga institucionet financiare | (1,394,866,729) | -1,354,963,083 | | (39,903,646) | |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | (34,620,504) | | | (34,620,504) | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | (341,578,643) | -279,204,586 | 0 | (55,613,810) | (6,760,247) |
| Te tjera te pagueshme | (16,601,436) | | | (16,601,436) | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | (2,906,234,728) | | | (2,906,234,728) | |
| **Pozicioni neto** | **(3,946,919,239)** | ***(1,489,825,815)*** | ***8,923,674*** | ***(2,459,284,485)*** | ***(6,732,613)*** |

| *01-Jan-22* | Vlera e mbartur | EUR | USD | LEK | Franga |
|---|---|---|---|---|---|
| Investime ne pjesemarrje | 2,800,000 | | | 2,800,000 | |
| Llogari te arketueshme tregtare | 266,368,353 | 56,883,599 | 6,593,080 | 202,891,674 | 0 |
| Shpenzime te shtyra | 145,722,605 | | | 145,722,605 | |
| Nga njesit ekonomike brenda grupit | 19,074,503 | | | 19,074,503 | |
| Te arketueshme te tjera | 30,392,294 | | | 30,392,294 | |
| Mjete monetare dhe të ngjashme | 65,210,691 | 32,138,256 | 2,194,332.99 | 35,158.15 | 30,842,944 |
| Huatë nga institucionet financiare | (1,293,896,003) | (1,293,896,003) | | | |
| Detyrime Personeli dhe tatimore | (17,273,167) | | | (17,273,167) | |
| Furnitorë dhe të tjera detyrime | (231,078,244) | (167,369,042) | (10,760) | (57,687,707) | (6,010,735) |
| Te tjera te pagueshme | (12,500,000) | | | (12,500,000) | |
| Detyrime te treteve ( Financime ortak) | (2,143,405,315) | | | (2,143,405,315) | |
| **Pozicioni neto** | **(3,168,584,283)** | **(1,372,243,190)** | ***8,776,653*** | **(1,829,949,955)** | ***24,832,209*** |

LAJTHIZA INVEST SH.A. - Production
Exp - Imp
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

**Huatë nga institucionet financiare**

| | 31-Dec-23 | 31-Dec-22 | 01-Jan-22 |
|---|---|---|---|
| Principal i pagueshem | 1,020,610,172 | 969,677,166 | 823,948,593 |
| Kosto financiare të shtyra | - | - | - |
| **Totali Afatgjata** | **1,020,610,172** | **969,677,166** | **823,948,593** |

| | 31-Dec-23 | 31-Dec-22 | 01-Jan-22 |
|---|---|---|---|
| Principali i pagueshem | 233,435,891 | 425,189,563 | 469,947,410 |
| Interesa të llogaritura | - | - | - |
| Kosto financiare të shtyra | - | - | - |
| **Totali Afatshkurtra** | **233,435,891** | **425,189,563** | **469,947,410** |
| **Totali hua nga institucione financiare** | **1,254,046,063** | **1,394,866,729** | **1,293,896,003** |

Më poshtë paraqitet klasifikimi i huase sipas maturitetit. Ndarja e detyrimeve financiare sipas maturitetit te tyre me 31 dhjetor 2023 tabelen qe vijojne:

| **31 dhjetor 2023** | **Me pak se 1 vit** | **1-5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Total** |
|---|---|---|---|---|
| Overdraft & Hua | 233,435,891 | 156,490,806 | 864,119,366 | 1,254,046,063 |
| Interes i perllogaritur | | | | |
| Kosto financiare te shtyra | | | | |
| **Totali** | **233,435,891** | **156,490,806** | **864,119,366** | **1,254,046,063** |

## 1. Informacion i përgjithshëm

Lajthiza Invest sh.a (referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Degës së Tatimpaguesve Kukes me NIPT J98009202P. Shoqëria është krijuar më datën 07 Shtator të vitit 1999 dhe eshte e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë prane QKR. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë eshte Prodhim, Ambalazhim,Tregtim i Uje Natyral ne Lajthize te Pukes. Aksionere e vetme e shoqerise eshte Znj.Lavdije Elezaj me pjesemarrje ne aksione 100%. Perfaqesuesi ligjor dhe drejtor egzekutiv i shoqerise eshte Z.Thanas Siveri.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte ne Tirane Kashar ,Rruga Locka
Më 31 dhjetor 2023 shoqëria ka të punësuar 379 punonjës

## 2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"). Pasqyrat financiare për vitin 2022 janë pasqyrat e para, të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të.Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2023 jane pergatitur ne perputhje me SNRF-te.

SNRF 1 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese të detajuara për efektin e tranzicionit nga SKK në SNFR, te cilat jane shpalosur ne Shenimin 5

Pasqyrat finaciare janë përgatitur në bazë të kostos historike dhe jane paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë si rrjedhoje e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur ne Lek, përvec aty ku shprehemi ndryshe.

## 3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht. Ndryshime ne cmuarjet dhe vleresimet kontabile njihen ne periudhen ne te cilen cmuarjet ndryshojne, dhe ne periudhat e ardhshme qe mund te preken nga ky ndryshim. Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë.

***Të ardhurat nga kontratat me klientë***

Shoqëria ka zbatuar gjykimet e mëposhtme që ndikojnë në përcaktimin e shumës dhe kohës së të ardhurave nga kontratat me klientët:

*a) Përcaktimi i kohës së përmbushjes së shërbimeve*

Shoqëria konkludon se e ardhura njihet ne momentin e realizimit te shitjes se produktit, ne momentin e dorezimit te mallit dhe leshimit te fatures. Dorezimi i produkteve ne ambjentet e klientit dhe marrja ne dorezim nga klienti perben permbylljen e detyrimit dhe njohjen e te ardhures nga shoqeria.

*b) Përcaktimi i konsideratës së ndryshueshme*

Shoqëria ka të drejtën e një ndëshkimi me pagesë të vonuar sipas kontratave të saj me klientët, gje e cila eshte specifikuar ne kontratat individuale me cdo klient.

## 3. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

***Të ardhurat nga kontratat me klientë (vazhdim)***

*c) Konsideratat kryesore kundrejt agjentëve*

LAJTHIZA INVEST SH.A. - Exp - Imp - Production
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

Shoqëria prodhon produktin uje dhe e tregton me ane te personelit te saj - agjenteve, direkt te klienti. Nuk ka pale ndermjetese kontraktuale qe te ndikoje ne njohjen e te ardhures pervecse rregjitrimit direkt ne kontabilitetin e Shoqerise.

***Tatimi mbi fitimin***

Shoqeria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Eshtë i nevojshem gjykimi per përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre te shtyra. Shoqeria njeh detyrimin ne rast te inspektimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund te lindin si detyrim. Nese tatimi perfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vleren aktuale te aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

***Rishikimi i zhvleresimit***

Rikuperimi i aktiveve është një cështje që kërkon gjykim të menaxhimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet e pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet SNRF kërkojnë që manaxhimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vleresimi i situatave te mundshme qe do te sillnin mosrekuperimin e vleres se aktiveve. Shoqeria ka kryer një plan tre-vjecar financiar, ku supozimet kryesore ishin norma e qeradhenies (në bazë te kontratave të qerasë aktuale), rritja vjetore në perqindjen e siperfaqes se dhene me qera, reduktim potencial te uljeve akorduar qeramaresve dhe të gjitha kostot e tjera financiare dhe kosto amortizimi te cilat bazohen në informacionin aktual në dispozicion per qendren. Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe testimet, Shoqeria ka arritur në përfundimin se nuk ka indikacione per zhvlerësim te aktiveve në 31 dhjetor 2022

**4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

**(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase "Lek", e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës se raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

**4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithperfshirese në periudhën në të cilën ndodhin.

Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin mesatar të këmbimit për secilën periudhë, përvec rasteve të luhatshmërisë së ndjeshme të kursit të këmbimit, nëse ka, të cilat do të paraqiten me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni.

| | Kursi mesatar | | Kursi në datën e raportimit | |
|---|---|---|---|---|
| | 2023 | 2022 | 2023 | 2022 |
| Lek/EUR | 108.80 | 118.98 | 103.88 | 114.23 |
| Lek/USD | 100.65 | 113.04 | 93.94 | 107.05 |
| Lek/Franga | 111.94 | 118.40 | 112.1 | 116.13 |
| Lek/GBP | 125.01 | 139.60 | 119.47 | 128.92 |

LAJTHIZA INVEST SH.A. - Production
Exp - Imp
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

**(b) Intrumentat financiarë**

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera, te arketueshme dhe te pagueshme nga njesite ekonomike te grupit. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letrat me vlerë të kapitalit dhe të borxhit të përdorura gjatë aktiviteteve

**i)** ***Aktivet Financiare***

***Njohja fillestare dhe matja***

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjitheperfshirese (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar dhe nga modeli i biznesit te Shoqerise për menaxhimin e tyre. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqeria ka zbatuar mjetet praktike maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar sipas SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjitheperfshirese, ajo duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar.

Modeli i biznesit i shoqerise Lajthiza Invest sh.a. për manaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si manaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset monetare do të rezultojnë nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale.

***Matjet e mëvonshme***

Për qëllime të matjes se mëvonshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit)
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit)

- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto)

- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se me kamatë) dhe janë subjekt i renies ne vlere (zhvlersimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Lajthiza Invest sha qe maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare dhe paratë dhe ekuivalentët e saj.

***Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre***

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak, të percaktuara si më sipër, e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

***Llogaritë e arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerën reale dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga rënia në vlerë.

LAJTHIZA INVEST SH.A - Production
Exp - Imp
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

***Huatë nga institucionet financiare***

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv. Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

***Zhvlerësimi i aktiveve financiare***

Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme lidhur me zhvlerësimin e aktiveve financiare paraqitet gjithashtu në shënimet e mëposhtme:

- dhënia e informacioneve shpjeguese për supozime të rëndësishme (shenimi 3)
- të arkëtueshmet tregtare

Shoqeria njeh një zbritje për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhen në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve monetare që Shoqeria pret të marrë, duke i zbritur një përafrim të normës fillestare të interesit efektiv. Flukset monetare pritet të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Për të arkëtueshmet tregtare dhe aktivet e kontratës, Shoqeria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e ECLs. Prandaj, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njeh një humbje të humbjes bazuar në ECL-të e jetës në çdo datë raportimi. Shoqeria ka krijuar një matricë për llogaritjen e humbjes të pritshme të kredisë (ECL) që bazohet në përvojën e saj historike të humbjes ekreditore, të përshtatura për faktorët e ardhshëm që janë specifikë për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

Shoqeria konsideron një aktiv financiar në vonese kur pagesat kontraktuale janë 90 ditë të kaluara. Megjithatë, në raste të caktuara, Shoqeria mund të konsiderojë gjithashtu një aktiv financiar në vonese kur informatat e brendshme ose të jashtme tregojnë se Shoqëria nuk ka gjasa të marrë shumat e papaguara kontraktuale në tërësi përpara se të marrë parasysh çdo përmirësim kredie të mbajtur. Një aktiv financiar shlyhet kur nuk ka pritshmeri të arsyeshme për rikuperimin e flukseve monetare kontraktuale. Përveç kësaj, Shoqeria konsideron se ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 90 ditë të kaluara. si në rastet më poshtë:
- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e saj të kreditit në Shoqëri në tërësi, pa rekurs nga Shoqëria për veprime; ose
- pasuria financiare është më shumë se 90 ditë e kaluara.

ECL-të e jetegjatesise janë ECL-të që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të parazgjedhur gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

ECL-të 12-mujore janë pjesë e ECL-ve që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit (ose një periudhë më të shkurtër nëse jeta e pritur e instrumentit është më pak se 12 muaj).

Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të ECL-ve është periudha maksimale kontraktuale mbi të cilën Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

***Çregjistrim***

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

**i)** ***Detyrimet financiare***

***Njohja dhe matja fillestare***

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshmet ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, sipas rastit. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe detyrimeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Detyrimet financiare të Lajthiza Invest sh.a. përfshijnë detyrimet tregtare dhe të tjera të pagueshme.

***Matja ne vijim***

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:
- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes
- kredi dhe huamarrje

***Çregjistrim***

Detyrimi financiar çregjistrohet kur detyrimi të zbatohet, anullohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si çregjistrimi i detyrimit fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri . Diferenca në vlerën kontabël përkatëse është njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

*Kompesimi (netimi)*

Aktivet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është e drejte ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe ka një synim për t'i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim, dhe në mënyrë specifike në ndonjë nga politikat kontabël të Shoqerisë

**(c) Aktive afatgjata materiale**

*Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit te aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

*Kostot në vijim*
Kostot për zëvëndësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose cdo kosto tjetër zëvëndësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20%.

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse janë të rëndësishme, aktivet afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

**(d) Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

**(e) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset neto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

**Të ardhurat nga shitja produktit**

Të ardhurat kryesore jane nga shitja e produktit uje ne formate te ndryshme. Kostot e ketyre produkteve njihen ne momentin e realizimit te shitjes dhe permbledhin gjithe kostot e fazave te prodhimit te produktit; lende e pare, materiale ndihmese, pune prodhuese, energji dhe shpenzime te tjera deri ne produktin e gatshem.

Te ardhurat nga kontratat me klientet jane specifikisht shitjet kundrejt klienteve sipas kontratave me to. Sipas SNRF 15, te ardhurat e njohura nga keto kontratat me klientet paraqiten paraqiten me momentin e shitjes dhe dergimit te mallit tek klienti, pra kontrolli i produkteve u kalon klienteve.

**(i) Të ardhurat dhe kostot financiare**

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

**(j) Kostot e huave**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin ë aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për tu sjellë në formë përfundimtare, në mënyre që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati që qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

**(k) Shpenzime për tatim fitimin**

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përvec rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

**(l) Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i shoqërisë është i njohur me vlerë nominale. Aksionet e zakonshme të shoqërisë klasifikohet si kapital.

**5. Raportimi per herë të dyte sipas SNRF-ve**

Këto pasqyra financiare, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023, janë të dytat të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF. Për periudhën që fillon më 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2022, Shoqëria ka përgatitur pasqyra financiare në përputhje me SNRF per here te pare.

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNRF-të e aplikueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023, së bashku me të dhënat për periudhën krahasuese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, siç është përshkruar në përmbledhjen e politikave kontabël të rëndesishme. Ky shënim shpjegon riklasifikimet e bëra nga Shoqëria në prezantimin e pasqyrave financiare SKK, duke përfshirë dhe pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021, dhe tranzicionin në SNRF. Nuk ka efekte të tjera të raportuara mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare nga tranzicioni i Shoqërisë nga SKK në SNRF.

Efektet e adoptimit të SNRF më 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

| | Shënime | Rezerve rivleresimi | Fitim i pashperndare | Riklasifikime | Fitim i pashperndare |
|---|---|---|---|---|---|
| | | SKK | SKK | | SNRF |
| **Gjendja më 1 janar 2023** | | 460,569,874 | 98,567,387 | - | **98,567,387** |
| Fitim i vitit | | - | 654,646,180 | - | 654,646,180 |
| Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera | | - | - | - | - |
| **Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse** | A | **0** | **654,646,180** | - | **654,646,180** |
| Riklasifikimi i nga fitimi i pashperndare ne kapital | | - | (60,000,000) | | (60,000,000) |
| Riklasifikim nga rezerva rivleresimi | | (21,464,597) | - | | - |
| Dividente te deklaruar | | | (38,567,387) | | (38,567,387) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2023** | | **439,105,277** | **654,646,180** | - | **654,646,180** |

| | Shënime | SKK | Rimatja | 31-Dec-22 |
|---|---|---|---|---|
| **Aktive** | | | | |
| Shpenzime te periudhave te ardhshme - Kontratat e Qerave | | 0 | 83,464,600 | 83,464,600 |
| | B | **SKK** | **Rimatja** | **31-Dec-23** |
| **Pasivi** | | | | |
| Detyrime të ardhshmeme të qerave | | 0 | 287,651,600 | 287,651,600 |

Shënime për rakordimin e pasqyrave të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023

B. Me adoptim e SNRF-ve Shoqëria njeh detyrimin per kontratat e qirave per te gjithe periudhen e kontratave se qirave duke rritur vlerën e Aktivit dhe rrjedhimisht Pasivit ne pasqyrat financiare. Konkretisht më 31 dhjetor 2023 kjo vlere e rritur ne pasqyren e pozicionit financiare eshte me Lek 287,651,600

## 6 Standardet e reja dhe amendimet

### 6.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende nuk janë efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato te hyjnë në fuqi.

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 Qiratë. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Standarti eleminon modelin aktual të kontabilitetit të dyfishtë për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eleminuar dallimin mes qirasë operative dhe financiare.

Sipas SNRF 16, kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tilla, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të cilin ka të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim. Aktivi zhvlerësohet dhe detyrimi akumulon interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillestare dhe më pas vijnë duke u ulur për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan këste fikse vjetore.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standartit per:
- qiratë afat shkurtra dhe;
- qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

Shoqëria planifikon të filloje aplikimin e SNRF 16 në 1 janar 2022 duke zbatuar modelin e qasjes retrospektive. Efekti kumulativ i aplikimit të SNRF 16 do të njihet si rregullim i balancës hapëse të fitimit të mbartur në 1 janar 2022, pa rishqyrtim të informacionit krahasues. Shoqëria planifikon të zbatojë lehtësi praktike për të trashëguar ndryshimin për përcaktimin e qirasë. Pra, do të aplikojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e lidhura para 1 Janarit 2022 dhe të identifikuara si qira në përputhje me SNK 17 dhe IFRIC 4.

**a. Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme**

Shoqëria ende nuk ka përfunduar një analize të ndikimit sasior të pritur të standartit të ri. Ndikimi faktik i adaptimit të standartit të ri në 1 Janar 2019 mund të ndryshojë pasi politikat e reja kontabël janë subjekt ndryshimi deri sa shoqëria të paraqesë pasqyrat e para financiare pas datës së aplikimit.
Ndryshimet që mund të jenë relevante për Shoqërinë, por nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të tij, janë paraqitur më poshtë:

KIFRN 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (në fuqi më 1 janar 2019).
Përmirësimet vjetore (cikli 2015-2017) (i detyrueshëm për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 Janar 2019).
Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimet e planit, kufizimet dhe vendbanimet" (të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).

**b. Standarde e publikuara dhe efektive**
Shoqeria ka aplikuar SNRF 15 dhe SNRF 9 për herë të parë që nga janari 2022. Natyra dhe efekti i ndryshimeve si rezultat i miratimit të këtyre standardeve të reja të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë. Përveç ndryshimeve të përshkruara më poshtë, politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të mëparshëm financiar.

**Adoptimi i SNRF 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët"**

Shoqëria vendosi të aplikojë metodën e thjeshtëzuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetet praktike të disponueshme për këtë kalim. Shoqeria aplikon SNRF 15 vetëm për kontratat që nuk ishin plotësuar deri më datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018). Standardi kërkon që efekti kumulativ i zbatimit fillimisht të SNRF 15 të njihet në datën e aplikimit fillestar si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të pashpërndara. Shoqëria konsideron se efekti kumulativ është jomaterial në pasqyrat financiare. Prandaj, informacioni krahasues nuk është riparaqitur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 11, SNK 18 dhe Interpretimet përkatëse.

**Adoptimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"**

SNRF 9 Instrumentet Financiare zëvendësojnë SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, duke bashkuar të tre aspektet e kontabilitetit të instrumenteve financiare: klasifikimi dhe matja; dëmtim; dhe kontabilitetin mbrojtës.

Lajthiza Invest sha ka aplikuar SNRF 9 prospektivisht, me një datë fillestare të aplikimit të datës 1 janar 2022. Shoqeria nuk ka riparaqitur informacionin krahasues, i cili vazhdon të raportohet sipas SNK 39. Dallimet që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 janë njohur drejtpërdrejtë në fitimet e pashpërndara dhe komponentë të tjerë të kapitalit. Shoqëria konsideron se efekti kumulativ është jomaterial në pasqyrat financiare. Prandaj, informacioni krahasues nuk është riparaqitur.

Disa ndryshime dhe interpretime të tjera zbatohen për herë të parë në 2022, por nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka bere aplikim të hershëm të të gjitha standardeve, interpretimeve apo ndryshimeve që janë publikuar, por nuk janë ende efektive.

*Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).*

*Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, varësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur njësia ekonomike së pari aplikon SNRF 9 për njësitë ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).*

*Përmirësimet vjetore të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (i publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).*

*KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).*

*Ndryshimet në SNK 40 - "Aktivet Afatgjata Materiale te Investuara" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).*

**7. Aktive afatgjata materiale**

| | Toka | Ndërtesa | Instalime teknike, makineri dhe paisje | Mjete Transporti | Paisje informatike dhe zyre | Aktive te tjera prodhim e proces | Parapagime per aktive materiale dhe ne proces | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 1 janar 2022** | 26,178,782 | 498,412,457 | 2,299,650,612 | 654,339,910 | 199,434,594 | 522,833,535 | 301,951,393 | 4,502,801,283 |
| **Rivleresime** | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Gjendja më 1 janar** | **26,178,782** | **498,412,457** | **2,299,650,612** | **654,339,910** | **199,434,594** | **522,833,535** | **301,951,393** | **4,502,801,283** |
| Shtesa | - | - | 602,914,438 | 121,863,790 | 140,581,654 | 199,693,949 | - | 1,065,053,831 |
| Pakesime | - | - | (10,336,150) | (30,259,596) | (326,186) | - | - | (40,921,932) |
| Transferime | - | - | - | - | - | - | (70,858,759) | (70,858,759) |
| Rivleresime | - | (12,051,801) | - | - | - | - | - | (12,051,801) |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2022** | **26,178,782** | **486,360,656** | **2,892,228,899** | **745,944,104** | **339,690,062** | **722,527,485** | **231,092,634** | **5,444,022,622** |
| Shtesa | | - | 250,769,775 | 162,116,756 | 34,064,585 | 241,191,884 | 138,143,764 | 826,286,764 |
| Pakesime | | - | - | (48,150,280) | - | - | - | (48,150,280) |
| Transferime | | - | - | | | | | - |
| Rivleresime | | (11,449,211) | - | | | | | (11,449,211) |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2023** | **26,178,782** | **474,911,445** | **3,142,998,675** | **859,910,579** | **373,754,647** | **963,719,369** | **369,236,398** | **6,210,709,895** |
| **Amortizim i akumuluar** | | | | | | | | |
| **Gjendja më 1 janar 2022** | - | **77,102,181** | **971,651,340** | **292,745,065** | **103,372,210** | | - | **1,444,870,796** |
| Amortizim i vitit | - | 9,013,713 | 339,628,952 | 78,857,897 | 35,096,486 | | - | 462,597,048 |
| Pakesime | - | - | (8,894,111) | (8,304,752) | (285,340) | | - | (17,484,203) |
| Transferime | - | - | - | - | - | - | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rivleresime | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2022** | - | **86,115,893** | **1,302,386,181** | **363,298,211** | **138,183,357** | - | - | **1,889,983,642** |
| Amortizim i vitit | - | 8,563,027 | 330,464,695 | 94,056,447 | 55,549,693 | - | - | **488,633,862** |
| Pakesime | - | - | - | (29,493,209) | - | - | - | **(29,493,209)** |
| Transferime | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Rivleresime | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2023** | - | **94,678,920** | **1,632,850,876** | **427,861,449** | **193,733,050** | - | - | **2,349,124,295** |
| | | | | | | | | |
| **Vlera kontabël neto** | | | | | | | | |
| **Gjendja më 1 janar 2021** | 37,703,342 | 443,484,501 | 1,126,900,642 | 321,737,269 | 87,136,266 | 192,215,627 | 160,779,735 | 2,369,957,383 |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2021** | **26,178,782** | **400,244,763** | **1,589,842,718** | **382,645,893** | **201,506,705** | **722,527,485** | **231,092,634** | **3,554,038,980** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2022** | **26,178,782** | **380,232,525** | **1,510,149,797** | **432,049,130** | **180,021,597** | **963,719,369** | **369,236,398** | **3,861,587,598** |

Më 31 dhjetor 2023, Shoqëria ka Aktivet afatgjata si me siper. Parapagimet ne shumen Lek 369,236,398 ne mbyllje te vitit 2023 jane kryesisht per Makineri dhe Materiale ndertimi etj. Shoqeria i ka amortizuar aktivet e saj bazuar ne normat tatimore sipas kategorive.

**8. Aktivet jo-materiale të tjera**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Aktive jomaterial - rivleresime Bruto | 200,307,719 | 210,850,231 | 221,947,612 |
| Pakesimi i rezerves se rivleresimit | (10,015,386) | (10,542,512) | (11,097,381) |
| **Total** | **190,292,332** | **200,307,719** | **210,850,231** |

Kjo shume rivleresimi ka te beje me procesin e rivleresimit te makinerive me vlere tregu, ne vitin kur eshte bere rivleresimi.

**9. Investime ne pjesemarrje**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Tituj pronesie | 34,000,000 | 23,800,000 | 2,800,000 |
| **Total** | **34,000,000** | **23,800,000** | **2,800,000** |

Shoqeria Lajthiza Invest sh.a. deri me 31 Dhjetor 2023 ka 34% (Lek 34,000,000) pjesemarrje te investuar ne kapitalin e shoqerive shqipëtare të tjera.

**10. Inventari**

| | 2022 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Lende e pare dhe materiale te konsumueshme | 1,131,989,705 | 1,161,819,833 | 858,426,971 |
| Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte | 72,432,964 | 70,130,792 | 44,926,897 |
| Produkte te gatshme | 37,516,370 | 215,520,376 | 71,674,629 |
| Parapagime per inventar | 112,073,923 | 37,929,716 | 58,840,616 |
| **Total** | **1,354,012,962** | **1,485,400,717** | **1,033,869,113** |

LAJTHIZA INVEST SH.A - Production
Exp - Imp
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

Inventaret perbehen ne pjesen me te madhe nga Lenda e I-re si granulat, pipeta, etiketa dhe tapa. Inventari i prodhimit ne proces jane uji I ambalazhuar I pa-paketuar akoma, ndersa produkti i gatshem jane Uji i ambalazhuar ne formate te masave te ndryshme. Inventari eshte matur me vleren me te ulet midis kostos se prodhimit dhe vleres se realizueshme neto.

## 11. Llogari të arkëtueshme tregtare

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Nga aktiviteti i shfrytezimit | 692,424,868 | 442,649,689 | 266,368,354 |
| **Total** | **692,424,868** | **442,649,689** | **266,368,354** |

Furnitoret nga aktiviteti shfrytezimit qe rezultojne gjendje ne fund vite jane kryesisht furnitoret per blerjen e lendes se pare si granulati, pipetat dhe etiketat. Shoqeria operon me terma te pageses se shtyre, pasi ka kryer parapagime . Keto detyrime shlyhen pergjate vitit pasardhes.

## 12. Shpenzime te shtyra

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Shpenzime te shtyra | 303,326,351 | 101,327,373 | 145,722,605 |
| **Total** | **303,326,351** | **101,327,373** | **145,722,605** |

Shpenzime te shtyra perbehet nga kontabilizimi i kontratave te qirase per gjithe termin e tyre ne perputhje me SNRF 16 Qiratë, si dhe nga shpenzimet e periudhave te ardhshme ne lidhje me kontratat e qirave financiare.

## 13. Te arketueshme te tjera

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Te arketueshme te tjera | - | 46,401,885 | 30,392,294 |
| Nga njesite ekonomike brenda grupit | 72,768,687 | 31,337,303 | 19,074,503 |
| **Total** | **72,768,687** | **77,739,188** | **49,466,797** |

Te arketueshme te tjera jane paradhenie te paguara nga shoqeria per furnizime.

## 14. Mjete monetare dhe të ngjashme

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| ***Arka*** | | | |
| Vlera monetare ne lek | 102,040 | 458,826 | 626,130 |
| Arka ne EUR, | - | - | 46,324 |
| Garanci bankare per kontrata shitje | 519,194 | 519,194 | 519,194 |
| Parapagim ne forme garancie i klientit | 157,180 | 500,000 | - |
| **Totali** | **778,414** | **1,478,020** | **1,191,648** |
| ***Banka*** | | | |
| Llogarite bankare | 86,672,051 | 99,988,531 | 64,019,043 |
| **Total** | **86,672,051** | **99,988,531** | **64,019,043** |
| **TOTAL** | **87,450,465** | **101,466,551** | **65,210,691** |

Shoqeria ka llogari ne 11 banka. Mjetet monetare ne monedhe te huaj jane konvertuar me kurset e fund vitit, respektivisht 103.88 Lek/ EUR dhe 93.94 Lek/ USD.

## 15. Kapitali dhe rezervat

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Kapitali aksionar | 854,000,000 | 724,000,000 | 407,000,000 |
| Prime te lidhura me kapitalin | 9,690,915 | 9,690,915 | |
| Rezerva nga rivleresimi | 11,378,623 | 11,378,623 | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Rezerva ligjore | 427,726,654 | 449,191,251 | 627,077,521 |
| Fitim i vitit | 654,646,180 | 98,567,387 | 99,978,204 |
| **Totali** | **1,957,442,372** | **1,292,828,176** | **1,134,055,725** |

Kapitali i shoqerise ne fund te vitit 2023 shumon ne Lek 854 mil. Gjate vitit 2023 kapitali eshte rritur me Lek 130 mil. Rritja eshte mundesuar nga transferimi i Lek 130,000,000 nga Rezerva rivleresimi dhe te tjera, Lek 60,000,000 nga fitimi i vitit te kaluar dhe Lek 70,000,000 nga fondezimet e aksionereve te shoqerise.

**16. Hua dhe detyrime te tjera afatgjata**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Hua afatgjate | 1,020,610,172 | 969,677,166 | 823,948,593 |
| **Totali** | **1,020,610,172** | **969,677,166** | **823,948,593** |

Shoqeria ka marre hua afatgjata per te mundesuar zhvillimin e saj ne linja prodhimi, automjete dhe mjete transporti. Nje pjese te ketij financimi ajo e ka mundesuar dhe me kontrata Leasing nga Raiffeisen dhe OTP. Shumat gjendje ne fund viti 2023 jane; per kredite afatgjata Lek 864,119,366 dhe detyrimet nga kontratat e leasing-ut jane Lek 156,490,806. Norma mesatare e interesit te kontraktuar nga bankat eshte ne nivelin e 3.32% norme vjetore. Kontratat e leasing- ut kane nje norme mesatare tek 6.8%. Afatet e kredive jane mesatarisht 7 vjecare, dhe Kontratat e Leasing-ut jane 5 vjecare.

**17. Te tjera te pagueshme**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Te drejta dhe detyrime ndaj aksionereve | 3,025,078,667 | 2,906,234,728 | 2,143,405,315 |
| **Totali** | **3,025,078,667** | **2,906,234,728** | **2,143,405,315** |

Kjo shume perben fondezim nga Aksioneri per nevojat e shoqerise ne vleren 2,737,427,067 leke dhe detyrime te ardhshme per kontratat e qerave ne vleren 287,651,600 leke. Shumat e kontribuara jane te justifikuara me kontrata.

**18. Huatë nga institucionet financiare**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Hua afatshkurter | 233,435,891 | 425,189,563 | 469,947,410 |
| **Totali** | **233,435,891** | **425,189,563** | **469,947,410** |

Huaja afatshkurter perbehet nga pjesa afatshkurter e kredive afatgjata dhe Overdraftet e kontraktuara per nevoja te kapitalit punues, si psh pagesa furnitoresh per Lende te I-re, dhe shlyrje te detyrimeve doganore e tatimore.

**19. Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme | 185,491,342 | 341,578,643 | 260,851,411 |
| **Totali** | **185,491,342** | **341,578,643** | **260,851,411** |

Furnitoret perbehen nga detyrime per faturat per Lende te I-re si granulat, pipeta, tapa dhe etiketa. Keto llogari te pagueshme zakonisht shlyhen brenda 90 diteve.

**20. Detyrime tatimore**

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Detyrime tatimore | 164,525,241 | 34,620,504 | - |
| **Totali** | **164,525,241** | **34,620,504** | **-** |

Kjo llogari perbehet nga paga dhe shperblime stafi rreth Lek 51 mil, detyrimet per sigurime rreth Lek 5.3 mil dhe diferenca jane Tatim mbi te ardhurat personale dhe tatim ne burim, dhe tatim fitimi per vitin 2023. Keto detyrime jane shlyer te gjitha ne Janar 2024 pervec tatim fitimit te vitit 2023 qe do te shlyhet ne mars 2024.

### 21. Te tjera te pagueshme

| | 2023 | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|
| Te tjera te pagueshme afatshkurtra | 9,279,578 | 16,601,436 | - |
| **Totali** | **9,279,578** | **16,601,436** | - |

Kjo llogari perbehet nga parapagime te bera nga klientet per produktin uje.

### 22. Te ardhurat nga aktiviteti kryesor

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 3,204,325,074 | 2,499,123,295 |
| **Totali** | **3,204,325,074** | **2,499,123,295** |

Te ardhurat nga aktiviteti kryesor jane te ardhurat nga shitja e produktit uje ne formate te ndryshme. Kryesisht shitjet me te medha kane qene nga formati 0.5 litra dhe 5 litra. Pervec mbulimit lokal ne Shqiperi shoqeria ka realizuar shitje ne rajon (Maqedoni, Kosove) dhe nje piese jane eksportuar dhe ne Mbreterine e Bashkuar.

### 23. Te ardhura te tjera

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhura nga investimet | 263,685,445 | 230,264,658 |
| Te ardhura te tjera | 192,044,646 | 96,550,006 |
| **Totali** | **455,730,092** | **326,814,664** |

Te ardhurat nga Investimet perbehen nga situacionime - shitje materiale ndertimi dhe te ardhurat e tjera jane realizuar kryesisht nga shitja nen-produketeve, materiale e furnitura dhe sherbime e qira.

### 24. Kosto e Mallrave dhe produkteve të shitura

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | 900,261,964 | 921,064,374 |
| Ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces | 172,248,057 | (143,845,747) |
| **Totali** | **1,072,510,021** | **777,218,627** |

Kosto e mallit te shitur perbehet nga blerje e lendes se pare te transferuar ne prodhim te periudhes, e rregulluar me ndryshimin e gjendjeve per prodhimin ne proces dhe inventarin ne fund viti.

### 25. Shpenzime personeli

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Shpenzime personeli | 254,167,043 | 220,500,268 |
| **Totali** | **254,167,043** | **220,500,268** |

Ketu perfshihen pagat, sigurimet dhe shperblimet e gjithe personelit per vitin financiar 2023. Gjithe personeli I shoqerise eshte me kontrata me kohe te plote dhe numri personelit ne fund viti eshte 379.

### 26. Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto | 43,856,398 | 130,823,737 |
| **Totali** | **43,856,398** | **130,823,737** |

Te ardhurat e tjera neto jane te ardhura te krijuara nga rivleresimi (efekti neto), te ardhura nga interesa bankare dhe nga shitja e aktiveve afatgjata, pasi jane zbritur shpenzimet nga interesi, komisionet dhe ngarkesat e tjera financiare.

LAJTHIZA INVEST SH.A - Production Exp - Imp Lajthiza Premium Water NATYRALE ALBANIA

**27. Shpenzime te tjera**

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Shpenzime te tjera | 1,117,947,135 | 1,383,875,890 |
| **Totali** | **1,117,947,135** | **1,383,875,890** |

Shpenzimet e tjera jane te natyres administrativo - operative si psh shpenzime per nafte, energji, taksa vendore, servise per mjete transporti, qira, utilitete dhe sherbime nga pale te treta.

**28. Tatim fitimi**

| | 2023 | 2022 |
|---|---|---|
| Fitimi Për vitin | 770,653,503 | 116,337,306 |
| Shpenziime te pazbritshme | (2,728,649) | (2,128,822) |
| **Fitimi Tatimor** | **773,382,153** | **118,466,128** |
| **Tatim mbi fitimin 15%** | **116,007,323** | **17,769,919** |

Shpenzimet e tatim fitimit janë llogaritur ne vlerën e referuar më sipër për të dy vitet e raportimit të kryer.

**29. Menaxhimi i rrezikut financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:
- rreziku i kreditit,
- rreziku i likuiditetit,
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proçeseve për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.
Menaxhimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë.
Politikat e menaxhimit të rrezikut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura të rrezikut, dhe për të monituar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve e proçedurave të menaxhimit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.
Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, të arkëtueshmet, të pagueshmet, dhe të tjera të pagueshme.

**(a) Rreziku i kreditit**
**Analiza e vjetersise per te drejtat e Arketueshme**

Analiza e vjetërsisë për të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, paraqitet si më poshtë:

| | | Me vonesë dhe të pazhvlerësuara | | | | | Te zhvleresuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vitet** | **Totali** | **Pa vonesë** | **30-60 ditë** | **61-90 ditë** | **91-120 ditë** | **Mbi 120 ditë** | |
| 2023 | **692,424,868** | 27,859,601 | 25,251,852 | 252,140,947 | 25,985,326 | 361,187,141 | |
| 2022 | **442,649,690** | -880,807 | 166,209,252 | 61,316,423 | 3,416,358 | 212,588,464 | - |
| 2021 | **266,368,353** | -2,229,913 | 28,552,779 | 27,323,939 | 4,798,519 | 207,923,038 | - |

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit të rrezikut të kreditit. Maksimumi i ekspozimit të kreditit në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

| | 31-Dec-23 | 31-Dec-22 | 01-Jan-22 |
|---|---|---|---|
| Mjete monetare dhe të ngjashme | 87,450,465 | 101,466,551 | 65,210,691 |

Exp - Imp - LAJTHIZA INVEST SH.A - Production
Lajthiza
Premium Water
NATYRAL
ALBANIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Të drejta të arkëtueshme, neto | 765,193,555 | 473,986,992 | 285,442,856 |
| Te arketueshme te tjera | 0 | 46,401,885 | 30,392,294 |
| Shpenzime te shtyra | 303,326,351 | 101,327,373 | 145,722,605 |
| **Totali** | **1,155,970,371** | **723,182,801** | **526,768,446** |

**Huatë nga institucionet financiare**

| | **31-Dec-23** | **31-Dec-22** | **01-Jan-22** |
|---|---|---|---|
| Principal i pagueshem | 1,020,610,172 | 969,677,166 | 823,948,593 |
| Kosto financiare të shtyra | - | - | - |
| **Totali Afatgjata** | **1,020,610,172** | **969,677,166** | **823,948,593** |

| | **31-Dec-23** | **31-Dec-22** | **01-Jan-22** |
|---|---|---|---|
| Principali i pagueshem | 233,435,891 | 425,189,563 | 469,947,410 |
| Interesa të llogaritura | - | - | - |
| Kosto financiare të shtyra | - | - | - |
| **Totali Afatshkurtra** | **233,435,891** | **425,189,563** | **469,947,410** |
| **Totali hua nga institucione financiare** | **1,254,046,063** | **1,394,866,729** | **1,293,896,003** |

Më poshtë paraqitet klasifikimi i huase sipas maturitetit. Ndarja e detyrimeve financiare sipas maturitetit te tyre me 31 dhjetor 2023 tabelen qe vijojne:

| **31 dhjetor 2023** | **Me pak se 1 vit** | **1-5 vjet** | **Mbi 5 vjet** | **Total** |
|---|---|---|---|---|
| Overdraft & Hua | 233,435,891 | 156,490,806 | 864,119,366 | 1,254,046,063 |
| Interes i perllogaritur | | | | |
| Kosto financiare te shtyra | | | | |
| **Totali** | **233,435,891** | **156,490,806** | **864,119,366** | **1,254,046,063** |

**(b) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo te ndonjë aktivi tjetër financiar.
Qëllimi i shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në ato të vështira, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të shoqërisë.

**Thanas SIVERI**
**Drejtor i përgjithshëm**

**Valbona ALUSHI**
**Drejtor i financës**